

Nr. prot. 329
2.7.2026



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI AKADEMIK

në mes të

Fakultetit të Filologjisë, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren

dhe

Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është zhvillimi dhe thellimi i bashkëpunimit akademik dhe shkencor ndërmjet Fakultetit të Filologjisë të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në përputhje me marrëveshjen ekzistuese të bashkëpunimit ndërmjet dy universiteteve.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Palët bien dakord të zhvillojnë bashkëpunim në këto fusha:

- shkëmbim të profesorëve dhe studiuesve për ligjërata, seminare dhe aktivitete akademike;
- shkëmbim të studentëve për aktivitete studimore dhe kërkimore;
- organizim të përbashkët të konferencave, seminareve, punëtorive dhe shkollave verore;
- realizim të projekteve të përbashkëta kërkimore dhe botimeve shkencore;
- shkëmbim të literaturës akademike dhe materialeve kërkimore;
- bashkëpunim në zhvillimin e programeve studimore dhe aktiviteteve akademike me interes të përbashkët.

Neni 3

Format e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet dy fakulteteve do të realizohet përmes:

- vizitave akademike reciproke të stafit;

- organizimit të aktiviteteve të përbashkëta akademike dhe kulturore;
- përfshirjes së përbashkët në projekte dhe iniciativa kërkimore;
- bashkëpunimit në mentorim dhe bashkëdrejtim të temave të studimeve master dhe doktoratë, kur është e mundur.

Neni 4

Koordinimi i aktiviteteve

Palët do të caktojnë persona kontaktues nga secili fakultet për koordinimin e aktiviteteve dhe për zhvillimin e iniciativave të përbashkëta.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe mbetet në fuqi për një periudhë pesëvjeçare, me mundësi vazhdimi me marrëveshje të përbashkët.

Neni 6

Ndryshimet

Çdo ndryshim apo plotësim i kësaj marrëveshjeje bëhet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve dhe në formë të shkruar.

Neni 7

Dispozitat përfundimtare

Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje identike në gjuhën shqipe, ku secila palë mban nga një kopje.

Për Fakultetin e Filologjisë

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren

Prof. assoc. dr. Vjollca Dibra



Shkodër, më 02 korrik 2026

Për Fakultetin e Shkencave Shoqërore

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Prof. dr. Artan Haxhi

